



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

**GJS-2023-009**

**Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 par.1 nënpar 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga palët A.R. dhe F.M., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren, me 6.06.2023, merr këtë:**

**A K T V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga palët A.R. e F.M., ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren – Sh.E..

**A r s y e t i m**

Ankuesit A.R., e F.M., më 16 maj 2023, i janë drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me kërkesë për anulimin e aktvendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren –Sh.E., mirëpo, meqë nga përmbajtja e kërkesës del se ankuesit me këtë ankesë kanë konsideruar se kryetarja e gjykatës ka shkel detyrën e saj, Kryetari i Gjykatës së Apelit më 24 maj 2023, konform nenit 9 par.2 të ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka përcjellë ankesën tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetares të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit ( neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Kështu, ankuesit pretendojnë se kanë kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren që ta përjashtojë gjyqtaren E.S., në lëndën N- C.nr.945/2020, për humbjen e lëndës N-C.nr.78/2011 datë 25.10.2013, dhe vendosjen e gabuar në lëndën N-C.nr.426/2015. Sipas ankuesve më 3.04.2023, i kanë paraqitur të gjitha provat dhe faktet të cilat gjenden në shkresat e kryetares, e cila fare nuk i ka marrë parasysh dhe e ka refuzuar kërkesën e tyre duk e mbrojtje gjyqtaren kriminele E.S.. Në të kundërtën sikur të ishin lexuar provat dhe faktet të cilat i kanë dokumentuar nuk do ta kishte marrë vendimin ogurzi datë 8.05.2023, por do ta kishte

përrjashtuar gjyqtaren nga gjykimi i lëndëve të lartcekura. Në lëndën N-C.nr.945/2020, paditësi A.M., nuk është blerës i shtëpisë tonë, por është një spekulant, shpifës dhe uzurpator. Në këtë drejtim ankuesit cekin provat e kësaj çështje si kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerisë datë 4.12.1997, ku shitës është A.M., ndërsa blerës F.M., dhe provat tjera të kësaj çështje. Me tej sipas ankuesve në lëndën C.nr.78/2011 gjyqtarja në seancën e datës 25.10.2013 ka deklaruar se pala paditëse ka pas fletëthirrje për gjykim, por kjo sipas ankuesve është rrenë e paskrupullt që kërkojnë të dëshmohet me flet thirrjen që e ka pranuar dhe nënshkruar K., dhe si provë e konsiderojnë kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme datë 21.01.2019. Kërkojnë që të hudhet si i pabazuar aktvendimi N-AD-GJTHPZ.nr.10/2023 datë 8.05.2023, në lëndën C.nr.78/11 të lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, dhe të përjashtohet gjyqtarja nga të gjitha lëndët.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve sa i përket shkeljeve disiplinore si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetarja e gjykatës të deklarohet lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratat e të njëjtëve.

Në deklaratën e saj kryetarja deklaroi se palët A.R. e F.M., kanë parashtruar kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës E.S., në lëndën civile C.nr.945/2020 (124/2009) dhe njëkohësisht kanë bërë kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj saj për shkak të vërejtjes në punën e saj. Këto palë kanë pas vërejtje në punën e gjyqtarës edhe për dy lëndë tjera, C.nr.78/2011 dhe C.nr.2079/19 por kërkesa për inicim të procedurës për këto dy lëndë nuk ka pasur. Sa i përket lëndës C.nr.78/2011 ku si paditës është K.M. ( i biri i A.M.) e njëjta ka përfunduar me aktvendim pasi që padia është konsideruar e tërhequr, kurse lënda me numër C.nr.2079/19 e njëjta është me ankesë në Gjykatën e Apelit. Sa i përket lëndës civile C.nr.945/2020 numri i vjetër ( 124/2009), padia është iniciuar nga ana e paditësit A.M., kundër të paditurve A.M., Q.M., R.M., për vërtetim të pronësisë. Kjo lëndë ka përfunduar me aktgjykimin C.nr.124/2009 datë 13.07.2015 dhe është aprovuar kërkesë padia e paditësit, por çështja është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit ku evidentohet me numrin C.nr.945/2020 dhe është në procedurë. Me 31.03.2023 i padituri A.M., ka kërkuar përjashtim të gjyqtarës për të dytën herë në këtë çështje ( në vitin 2020 kërkesën për përjashtim e ka refuzuar UD kryetari i gjykatës A.S.). Por, gjyqtarja E., e hedhë poshtë kërkesën pasi që konform nenit 69 par.1 pika b ( nuk është e lejuar kërkesa për përjashtim kur për të njëjtën kërkesë është vendosur njëherë), kurse sipas nenit 69 par.2 të LPK këtë kërkesë e hedh poshtë gjyqtari i çështjes. Kërkesën për inicim të procedurës e ka refuzuar sepse nuk ka pas bazë për inicim të procedurës dhe as bazë për përjashtim ngase ankuesit ju referohen provave dhe fakteve të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e të drejtës së tyre.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesit e ankesës, provave të cilat ja kanë bashkëngjitur ankesës, deklaratës së Kryetarës së Gjykatës, vlerësojë se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur procedurë disiplinore.

Së pari, ankesa është dukshëm joserioze, ngase nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryer nga kryetarja e Gjykatës.

Se dyti, vlerësoj se ankesa në rastin konkret ka të bëjë me pakënaqësitë e ankuesve rreth vendimeve të marra gjatë procedurës nga ana e gjyqtares së çështjes dhe kryetares së gjykatës për vendimet e marra për përjashtim të gjyqtares, të cilat kërkohen të anulohen. Në këtë drejtim si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj mënyrën e vendosjes së kryetares ( edhe pse në këtë rast del se kryetarja s'ka marrë vendim për përjashtim të gjyqtares së çështjes por rreth kërkesës për inicim të procedurës disiplinore) dhe vendimit të marr nga gjyqtari i çështjes, ngase gjyqtarët por edhe Kryetari i Gjykatës janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre respektivisht në punën e tyre.

Nga arsyet e cekura e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren,
3. Palëve ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.